



Universiteti Bujqësor i Tiranës pjesë e konsorciumit “Aleanca e Ekselencës Bioekonomike për Stimulimin e Tranzicionit të Gjellbër Inovativ dhe Gjithëpërfshirës ([BEAMING](#))”

Në këtë konsorcium (BEAMING) të udhëhequr nga Universiteti i Teknologjisë dhe Ekonomisë së Budapestit, Universiteti Bujqësor i Tiranës bëhet bashkë me shumë homologë të tjerë nga Europa dhe Ballkani Perëndimor. Ky projekt financohet nga programi i Bashkimit Evropian “Horizon Europe” për Kërkim dhe Inovacion.

[BEAMING](#) është një projekt Horizon Europe në kuadër të programit të punës WIDERA i cili synon të promovojë inovacionin dhe vlerësimin e njohurive në fushën e bioekonomisë përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, me fokus të veçantë në zgjerimin e vendeve në Evropën Qendrore-Lindore, Evropën Juglindore dhe Ballkanin Perëndimor.

Projekti do të bashkojë IAL nga rajone të ndryshme, duke promovuar transferimin e njohurive dhe teknologjisë dhe duke nxitur një kulturë bashkëpunimi të fokusuar tek forcimi i aftësive dhe kapaciteteve të studiuesve të karrierës së hershme në kërkimin bioekonomik, nxitja e reformës institucionale, nxitja e bashkëpunimit ndërdisiplinor, rritja e transferimit të teknologjisë dhe inkurajimi i një kulture institucionale gjithëpërfshirëse

Në thelb, bioekonomia është një sistem ekonomik që përdor burimet biologjike të rinovueshme për të prodhuar një gamë të gjerë mallrash dhe shërbimesh, duke synuar qëndrueshmërinë dhe reduktimin e varësisë nga burimet jo të rinovueshme.

Për më shumë mund të informoheni në faqen web të projektit, ose në LinkedIn dhe X:



<https://beamingproject.eu/>



[BEAMING PROJECT](#)



[BEAMING PROJECT](#)